



Data: 12.04.2019

Ref.: 590/19D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 66-të, të mbajtur më 27 mars 2019, mori:

### V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht ankesa Nr.435/19H, datë 15.03.2019 e Kolegjit AAB, si e bazuar.
2. Anulohet pika 1.2 e vendimit të KSHC-së Nr.299/19D, datë 22.02.2019 me te cilën është tërhequr akreditimi i programit të studimit, Menaxhment dhe Informatikë, MSc, 120 ECTS.
3. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr.299/19D, datë 22.02.2019 mbetet e pa ndryshuar.

### Arsyetimi

KSHC me vendim Nr.299/19D, datë 22.02.2019 ka tërhequr akreditimin e programeve të studimit si në vijim: Komunikim Masiv – Gazetari, MA, 120 ECTS; Menaxhment dhe Informatikë, MA, 120 ECTS; Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS, (dega në Gjakovë); Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS, (dega në Ferizaj); Gjuhe Angleze, BA, 180 ECTS (dega në Gjakovë); Menaxhment dhe Informatikë, BSc, 180 ECTS, (dega në Ferizaj); Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, BA, 240 ECTS, (dega në Ferizaj), dhe Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, BA, 240 ECTS; (dega në Gjakovë).

Kolegji AAB, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KSHC-së Nr.299/19D, datë 22.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë me datë 15.03.2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016).

Përmes kësaj ankesa, Kolegji AAB ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth kualifikimit dhe fushës së studimit për stafin akademik për programin e studimit, Menaxhment dhe Informatikë, MSc, 120 ECTS, i cili ka qenë objekt i trajtimit me vendimin e KSHC-së Nr.309/19D, datë 11.02.2019.

Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë për këtë program të studimit, janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 66-të të KSHC-së, të mbajtur me 27 mars 2019, dhe në fund, KSHC erdhi në përfundim që



Data: 12.04.2019

Ref.: 590/19D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 66-të, të mbajtur më 27 mars 2019, mori:

### V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht ankesa Nr.435/19H, datë 15.03.2019 e Kolegjit AAB, si e bazuar.
2. Anullohet pika 1.2 e vendimit të KSHC-së Nr.299/19D, datë 22.02.2019 me te cilën është tërhequr akreditimi i programit të studimit, Menaxhment dhe Informatikë, MSc, 120 ECTS.
3. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr.299/19D, datë 22.02.2019 mbetet e pa ndryshuar.

### Arsyetimi

KSHC me vendim Nr.299/19D, datë 22.02.2019 ka tërhequr akreditimin e programeve të studimit si në vijim: Komunikim Masiv – Gazetari, MA, 120 ECTS; Menaxhment dhe Informatikë, MA, 120 ECTS; Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS, (dega në Gjakovë); Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS, (dega në Ferizaj); Gjuhe Angleze, BA, 180 ECTS (dega në Gjakovë); Menaxhment dhe Informatikë, BSc, 180 ECTS, (dega në Ferizaj); Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, BA, 240 ECTS, (dega në Ferizaj), dhe Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, BA, 240 ECTS; (dega në Gjakovë).

Kolegji AAB, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KSHC-së Nr.299/19D, datë 22.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë me datë 15.03.2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016).

Përmes kësaj ankesa, Kolegji AAB ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth kualifikimit dhe fushës së studimit për stafin akademik për programin e studimit, Menaxhment dhe Informatikë, MSc, 120 ECTS, i cili ka qenë objekt i trajtimit me vendimin e KSHC-së Nr.309/19D, datë 11.02.2019.

Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë për këtë program të studimit, janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 66-të të KSHC-së, të mbajtur me 27 mars 2019, dhe në fund, KSHC erdhi në përfundim që


ankesa është pjesërisht e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës për programet e studimit, Menaxhment dhe Informatikë, MSc, 120 ECTS, i plotësojnë kushtet për të qen bartës të programit të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Pjesën tjetër të ankesës për programet e studimit: Komunikim Masiv – Gazetari, MA, 120 ECTS; Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS, (dega në Gjakovë); Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS, (dega në Ferizaj); Gjuhe Angleze, BA, 180 ECTS (dega në Gjakovë); Menaxhment dhe Informatikë, BSc, 180 ECTS, (dega në Ferizaj); Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, BA, 240 ECTS, (dega në Ferizaj), dhe Përkujdesi dhe Mirëqenie e Fëmijëve, BA, 240 ECTS; (dega në Gjakovë), KSHC vendosi që këtë çështje ta referoj për vendimmarrje në Komisionin e Ankesave, bazuar në pikën pesë të nenit 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe inicimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Kolegji AAB;
- MASHT-it, dhe
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

